



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe M...

Data

Nr. Prot

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË”
PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E PJESHME PËR KRYETAR TË BASHKISË
KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Komisionit Rregullator ose Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

Neni 64 i Kodit Zgjedhor parashikon detyrimin e çdo partie politike për të paraqitur kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ dhe dokumentacionin përkatës.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 186, datë 11.8.2023, ka caktuar datën 24 shtator 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës.

“Partia Demokratike e Shqipërisë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Nard Ndoka, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023.

Nga partia politike “Partia Demokratike e Shqipërisë” është paraqitur dokumentacioni vijues:

- Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 6.9.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Demokratike e Shqipërisë”, me initiale “PDK”, me kryetar z. Nard Ndoka, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).



Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Demokristiane e Shqipërisë” me shkronja nistore “PDK”, me adresë “Rruga “Muhamet Gjollësja”(ish Shtëpia Botuese e Librit Shkollor 8 Nëntori), Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Nard Ndoka, me adresë, Rruga “ Sheh Ahmet Pazari,” nr. 147, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është znj. Ariona Hoxha, me adresë rruga “5 Maji”, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është zj. Ariona Hoxha, me adresë, Rruga “ 5 Maji”, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Për sa më lart në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Demokristiane e Shqipërisë”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023”.

Valbona BALLGJINI - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Majlinda ÇELMETA - Drejtorja e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: .2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË” PËR
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJETE E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË
KUKËS TË DATËS, 24 SHTATOR 2023**

Sot më datë 6 .9.2023, në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur në datë 31.8.2023, me:

Kërkues: Partia politike “Partia Demokratike e Shqipërisë”, me kryetar z. Nard Ndoka

Objekti: Regjistrimi i partisë politike “Partia Demokratike e Shqipërisë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 186, datë 11.8.2023, ka caktuar datën 24 Shtator 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës.

“Partia Demokratike e Shqipërisë”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Nard Ndoka, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 shtator 2023.

Data: 2023 Nr:
Ora:



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Demokratike e Shqipërisë” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

Nga partia politike "Partia Demokratiane e Shqipërisë" është paraqitur dokumentacioni vijues:

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 6.9.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se "Partia Demokratiane e Shqipërisë", me initiale "PDK", me kryetar z. Nard Ndoka, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është "Partia Demokratiane e Shqipërisë" me shkronja nistore "PDK", Rruga "Muhamet Gjollësia" (ish Shtëpia Botuese e Librit Shkollor 8 Nëntori), Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Nard Ndoka, me adresë, Rruga "Sheh Ahmet Pazari" nr. 147, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është zj. Ariona Hoxha me adresë Rruga "5 Maji", Tiranë;
- d) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është zj. Ariona Hoxha, me adresë, Rruga "5 Maji", Tiranë;
- e) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga "Partia Demokratiane e Shqipërisë", respekton afatin kohor të parashikuar në nenin 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga "Partia Demokratiane e Shqipërisë", është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023, "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore", dhe vendimit të Komisionit Rregullator nr. 28 datë 16.8.2023 "Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për Kryetar në Bashkinë Kukës, që do të zhvillohen më datë 24 Shtator 2023".

Data: 2023 Nr:
Ora:



"Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike "Partia Demokratiane e Shqipërisë" për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023".

VENDOS:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Demokristiane e Shqipërisë”, me kryetar z. Nard Ndoka, me shkronjat nistore “PDK”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 Shtator 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 2023 Nr:
Ora:



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Demokristiane e Shqipërisë” për regjistrimin si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.